



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 03 datë 16/06/2018

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI
6% PËR PERIU DHËN 1-31 MAJ 2018**

Në mbështetje të nenit 29,30/1,31 të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar me Ligjin 44/2016, datë 21.04.2016, në pikën 6 të Kreut II të Vendimit nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, ndryshuar me Vendimin nr.592, datë 18.10.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2018 në total **8 (tetë)** familje, me fond total prej **29320 (njëzetë e nëntë mijë e treqind e njëzetë)** lekë. Konkretisht:

PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2018 **4 (katër)** familje, me një fond **14920 (katërmbydhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE STRUM

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2018 **2 (dy)** familje me një fond **8100 (tetë mijë e njëqind)** lekë.

PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE KUMAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2018 **1 (një)** familje, me një fond **3600 (tre mijë e gjashtëqind)** lekë.

PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE KURJAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2018 **1 (një)** familje, me një fond **2700 (dy mijë e shtatëqind)** lekë.



Bashkia Roskovec
Maj 2018


FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Artenisa Bujar Kola		4	Familje në nevojë	4860
2	Agron Jani Kola		1	Familje në nevojë	2600
3	Hatixhe Abas Bilani		4	Familje në nevojë	4860
4	Agron Osmën Çanta		1	Familje në nevojë	2600
	Shuma				14920

Mbyllet me nr rendor 4 (katër)

KRYETAR KËSHILLI

Eleni Goga




Njësia Administrative Strum
Maj 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Zamira Kadri Cjapi		4	Familje në nevojë	4500
2	Margarita Ahmet Selimaj		3	Familje në nevojë	3600
	Shuma				8100

Mbyllet me nr rendor 2 (dy)

KRYETAR KËSHILLI
Eleni Goga



FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Brunilda Andon Puli		3	Familje në nevojë	3600
	Shuma				3600

Mbyllet me nr rendor 1 (një)

KRYETAR KËSHILLI

Eleni Goga



Njësia Administrative Kurjan
MAJ 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesit Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Sose Sulo Kojku		2	Familje në nevojë	2700
	Shuma				2700

Mbyllet me nr rendor 1 (një)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 14. DATE 16. 06. 2018

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.73 DATË 24.11.2017“PËR MIRATIMIN E
PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2018”” DHE “RREGULLORJA E ORGANIZIMIT DHE
FUNKSIONIMIT TË STRUKTURËS VENDORE TË APELIMIT TATIMOR NGA NJËSITË
E VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të ligjin nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen vendore”, të ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar ,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- Miratimin e një shtesë në Vendimin Nr.73 datë 24.11.2017 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2018”, si më poshtë :

Për qytetaret e regjistruar në gjëndjen civile si banor të qytetit të Roskovecit por që jetojnë në një shtet tjetër për pagesen e tarifave familjare duhet të sjellin:

1. Një vërtetim që banojnë ose janë resident në shtetin e huaj
2. Fotokopje të pashaportës

Në bazë të vlerësimit të dokumentacionit të sjellë pranë zyrës së tatim - taksave do të bëhet dhe përlllogaritja e detyrimit.

Baza e llogaritjes së detyrimit do të jetë periudha ditore e qëndimit

*(Nr. Ditëve * Tarifa e pastrimit vjetore/365)*

*Shembull 15*700/365=28.7 lekë*



- Miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Strukturës Vendore të Apelitit Tatimor nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, si më poshtë :

PËRMBAJTJA

1. Organizimi i Strukturës Vendore të Apelitit Administrativ të Taksave e Tarifave Vendore
2. Objekti I Apelitit
3. Dorëzimi I Ankimit Administrativ Tatimor Vendor
4. Veprimet e Ndërmarra nga Struktura Vendore e Apelitit
5. Afati i shqyrtimit të Ankimit në Strukturën Vendore dhe e Drejta e Ankimit të Taksapaguesit Kundër Vendimit të Kësaj Struktore
6. Rimbursimi i Detyrimit Tatimor Vendor në Rastet e Parapagimit në Procesin e Ankimit Administrativ
7. Ekzekutimi i Vendimit të Strukturës Vendore të Apelitit dhe Apeliti në Gjykatë

KRYETAR

Eleni Goga



71. ORGANIZIMI I STRUKTURËS VENDORE TE APELIMIT ADMINISTRATIV TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Bazuar në specifikat që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore ka nga pikëpamja e numrit të popullsisë, bizneseve dhe burimeve njerëzore në Bashki, është e këshillueshme, që ato të mund adaptojnë një prej formave të mëposhtme si strukturë të apelimit administrativ të taksave dhe tarifave vendore:

- A. Drejtoria e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore - Organizimin dhe funksionimin e një Drejtorie të posaçme; ose
- B. Komisioni i Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore - Organizimin dhe funksionimin e një Komisioni të përbërë nga punonjës të departamenteve të ndryshme të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore.

A. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË APELIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Drejtoria e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore është pjesë përbërëse e strukturës organike të Bashkisë dhe kryen funksion të pavarur në vendimmarrje në lidhje me ankimin administrativ tatimor vendor. Kjo drejtori është struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe shqyrtimin e të gjitha ankimeve të depozituara nga taksapaguesit në përputhje me Rregulloren e miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Marrëdhëniet e punës për personelin e Drejtorisë së Apelit Tatimor rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

Struktura organike e saj hartohet dhe miratohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

B. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT VENDOR TË APELIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Komisioni i Apelit përbëhet nga jo më shumë se 5 anëtarë të cilët janë përfaqësues të Drejtorive juridike/ligjore, të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, një nënkryetar Bashkie dhe/ose përfaqësues të njësisë së urbanistikës. Numri i anëtarëve përcaktohet nga vetë NJQV-të në përputhje me specifikat dhe numrin e punonjësve në organikën e saj. Komisioni ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me një mandat 1 vjeçar me të drejtë riemërimi. Në rast të nevojës për ndryshim/zëvendësim të anëtarëve të komisionit, Kryetari i Bashkisë bën ndryshimin/zëvendësimin e anëtarit përkatës me një punonjës tjetër.

Të paktën një punonjës i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore shërben si Sekretar administrativ i Komisionit. Sekretari administrativ duhet të jetë i diplomuar në shkencë ekonomike ose juridike, të ketë njohuri të mira në nivel teknik mbi legjislacionin tatimor si dhe të ketë të paktën 2 vite përvojë pune në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Anëtarët e Komisionit Vendor të Apelit Tatimor duhet të jenë të diplomuar në degë përkatëse të përshtatshme me funksionin dhe veprimtarinë e këtij komisioni si dhe të kenë të paktën 2 vite përvojë pune në fushën përkatëse.

Duke qenë organ kolegjal me të drejtë vote, Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, e cila duhet të mbahet brenda 7 ditësh pune nga data e daljes së urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, zgjedh



Kryetarin dhe Sekretarin administrativ. Propozohen të paktën dy anëtarë për t'u zgjedhur si kryetar dhe nëpërmjet votimit, kryetar zgjidhet anëtari që merr 50 përqind të votave plus 1 votë, pra 3 vota. Në rast se nuk arrihet zgjedhja e Kryetarit dhe Sekretarit, pasi asnjeri nuk merr votat e mjaftueshme, edhe pas raundit të dytë të votimit, atëherë ata emërohen në detyrë nga Kryetari i Bashkisë me vendim të posaçëm.

Kryetari dhe anëtarët e komisionit mund të ndryshohen në çdo kohë, në rastet kur:

- a. nuk marrin pjesë në tri mbledhje radhazi të komisionit, pa shkaqe të justifikuara;
- b. japin dorëheqjen;
- c. janë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi
- d. përfundojnë marrëdhënien e punës me bashkinë;
- e. bëhen të paafte nga ana shëndetësore për të kryer funksionet e ngarkua

B.1. KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT VENDOR TË APELIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

i. Kryetari i Komisionit i cili është një nga anëtarët, ushtron këto detyra:

- a. cakton datën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së komisionit dhe vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje;
- b. drejton zhvillimin e mbledhjeve të komisionit;
- c. mbikqyr veprimtarinë e sekretariatit të komisionit;
- d. cakton anëtarin/anëtarët që do të relatojnë ankimin për shqyrtim nga Komisioni në mbledhjen e radhës;
- e. raporton për ecurinë e veprimtarisë së Komisionit pranë Kryetarit të Bashkisë brenda muajit dhjetor të çdo viti ose sa herë i kërkohet prej tij;
- f. ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
- g. nënshkruan vendimet e Komisionit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

ii. Anëtarët e Komisionit ushtrojnë këto detyra:

- a. marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komisionit dhe njoftojnë paraprakisht në rast mungese duke paraqitur dhe arsytet e mungesës;
- b. votojnë për çështjet e rendit të ditës, bazuar në parimin e profesionalitetit dhe ndershmërisë;
- c. deklarojnë, para votimit të çdo çështjeje, nëse janë në kushtet e konfliktit të interesit;
- d. secili prej anëtarëve raporton para komisionit çështjen e caktuar;
- e. ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.
- f. nënshkruajnë vendimet e Komisionit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

iii. Sekretariati administrativ i Komisionit ushtron këto detyra:

- a. merr në dorëzim ankimet që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimarrjes së Komisionit;
- b. shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
- c. njofton kryetarin e komisionit për çdo ankimim të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të ankimit;
- d. njofton ankimuesin të paktën 7 ditë pune përpara për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit.
- e. mban dhe harton procesverbalin e mbledhjes;



f. zbardh vendimin e arsytuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
g. Ruan konfidencialitetin.

Komisioni gjatë shqyrtimit të një ankimi ka të drejtë të kërkojë nga palët çdo informacion shtesë, ose të dhëna plotësuese që i gjykon të nevojshme, si dhe ka të drejtë të bëjë verifikime, në funksion dhe për qëllime të shqyrtimit të ankimit.

B.2. ORGANIZIMI DHE PROCEDURA PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJEVE

Komisioni mblidhet me kërkesën Kryetarit ose e të paktën 2 anëtarëve të tij, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e depozitimit të ankimit. Rendi i ditës dhe data e mbledhjes caktohet nga kryetari dhe u njoftohet anëtarëve të komisionit nëpërmjet sekretariatit, të paktën shtatë ditë pune përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj.

Mbledhja e Komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë të komisionit. Kur kjo shumicë nuk është arritur, caktohet një datë tjetër, brenda tri ditëve pune. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet pa vonesë, çdo anëtar dhe ankimuesi apo përfaqësuesi i tij.

Komisioni mund të mblidhet më shumë se një herë për të njëjtën çështje sipas nevojës.

Vendimet në çdo rast merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Komisionit të pranishëm në mbledhje. Komisioni merr vendime vetëm për kërkesa për apelim, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.

Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal me shkrim, i cili është një përmbledhje të gjithë procesit: datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, arsytimi, vendimet që u morën, si dhe rezultati i votimeve.

Procesverbali mbahet nga sekretariati dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët në përfundim të mbledhjes ose në fillimin e mbledhjes pasardhëse.

2.OBJEKTI I APELIMIT

Është objekt apelimi administrativ pranë Strukturës Vendore të Apelit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore çdo akt administrativ apo mosveprim për nxjerrjen e një akti administrativ nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me një taksë dhe/ose tarifë vendore.

2.1 Akti administrativ i vlerësimit të pasurisë së paluajtshme/ndërtesë, për qëllime të taksës së ndërtesës Taksapaguesit subjekt të taksës së ndërtesës, kanë të drejtë të kundërshtojnë administrativisht vlerësimin e bërë nga autoritetet përkatëse të vlerës së pronës për kategorinë ndërtesë, fillimisht duke paraqitur një Kërkesë për Korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës në rastet e saktësisimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, qëllimin e përdorimit të ndërtesës dhe çmimeve përkatëse. Një kërkesë e tillë mund të paraqitet edhe në rast se ankimuesi gjykon se ndërtesa e tij është objekt përjashtimi nga ligji. Nëse taksapaguesi nuk bie dakord me vendimin e strukturës përkatëse/ Drejtorisë ose Zyrës së Taksave/ose Agjentit të mbledhjes së taksës ndaj kërkesës për korrigjim, atëherë ai ka të drejtë të ankohet pranë Strukturës Vendore të Apelit Administrativ të Taksave dhe Tarifave.

2.1.1. Korrigjimi i të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës së ndërtesës në rastet e saktësisimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, qëllimin e përdorimit dhe çmimet përkatëse



Taksapaguesi, ka të drejtë të kërkojë korigjimin e detyrimit në çdo kohë, kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë nuk është bërë në përputhje me parashikimet e VKM nr. 132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kriteret dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” apo kur ky vlerësim ka pasaktësi për sa i takon të dhënave të përdorura.

Taksapaguesi, pas marrjes së njoftimit të detyrimit për taksën e pasurisë, kur nuk është dakord me këtë vlerësim, ka të drejtë të bëjë kërkesë për korigjimin e vlerës:

a) në Drejtorinë/zyrën e taksave dhe tarifave vendore të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme “ndërtesë”;

b) në zyrën e agjentit të mbledhjes së taksës, për rastet kur në këto zyra, shërbimi i korigjimit ofrohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore me punonjësit e saj.

Për të disiplinuar dhe unifikuar procedurat e korigjimit, taksapaguesit plotësojnë një formular tipik dhe që bëhet pjesë e Rregullores. Formulari i plotësuar shoqërohet gjithnjë me dokumentacionin justifikues e plotësues.

Drejtoria/Zyra e Taksave Vendore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, bën shqyrtimin e kërkesës së subjektit dhe vendos:

1. Të pranojë kërkesën për korigjim dhe bën korigjimin e vlerës nëse vlerësimi fillestar është bazuar mbi të dhëna të gabuara apo ka gabime në përlllogaritje;
2. Të refuzojë kryerjen e korigjimit dhe arsyeton me vendim arsyet e refuzimit të kërkesës për korigjim. Procedurat e korigjimit, NUK kushtëzohen me ndonjë detyrim nga ana e tatimpaguesit për të parapaguar taksën për të cilën është bërë kërkesa për korigjim.

2.1.2. Ankimi administrativ pranë Strukturës Vendore të Apelit Administrativ të Taksave dhe Tarifave.

Taksapaguesi ka të drejtë, që nëse nuk është dakord me vendimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me kërkesën e tij për korigjim, të ankimojë këtë vendim pranë Strukturës Vendore të Apelit, brenda një afati prej 30 ditësh nga data kur është marrë apo konsiderohet të jetë marrë njoftimi. Kanë të drejtë të paraqesin ankim pronarët e ndërtesës/njësisë pronësore apo përdoruesit e saj, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” I Sugjeruar sipas modelit që i bashkëlidhet këtij Udhërrëfyesi në Aneksin I 13 dhe zhvilluesit të cilët nuk arrijnë të përfundojnë ndërtimin brenda afateve të përcaktuara në lejen përkatëse, të lëshuar nga autoriteti përkatës i planifikimit.

Taksapaguesi mund të ankimojë taksën mbi pasurinë e paluajtshme/ndërtesë pasi vlerësimi i taksës së pasurisë nuk është i drejtë si rezultat i:

1. Të dhënave të pasakta;
2. Vendndodhjes së pasurisë dhe çmimeve përkatëse,
3. Normës tatimore të pasaktë, bazuar në qëllimin e përdorimit të pasurisë
4. Dhe çdo arsye tjetër që ndikon në detyrimin e tij tatimor.

Struktura Vendore e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me ankimin e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme/ndërtesë kryen këto detyra:



- a. Planifikon dhe mban mbledhje të rregullta për shqyrtimin e ankimeve, brenda një periudhe prej 30 ditë kalendarike, nga dita e pranimit të ankimeve;
- b. Mund të kërkojë praninë e ankimesit, për dëgjim para kësaj Struktore për të sqaruar arsyen e ankimit dhe për të sjellë çfarëdo dokumenti apo prove që mund ta mbështesë ankimin;
- c. Mund të kërkojë të dhëna shtesë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore apo nga zyra e agjentit për mbledhjen e taksës;
- d. Mund të inspektojë pronën e paluajtshme, kur vlerësohet se një veprim i tillë është në shërbim të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Struktura Vendore e Apelitit merr vendim duke:

1. Refuzuar ankimin për shkak se e konsideron të papranueshëm për mungesë të kriterëve formale sipas pikës 3(i) të këtij Udhërrëfyesi;
2. Lënë në fuqi aktin administrativ objekt apelimi ;
3. Shfuqizuar aktin administrativ objekt apelimi dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë pranë ministrisë përgjegjëse për financat për të reflektuar ndryshimet në Regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme (Kadastër);
4. Shfuqizuar pjesërisht aktin administrativ objekt apelimi dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë pranë ministrisë përgjegjëse për financat për të reflektuar ndryshimet në Kadastër.

2.2. Çdo akt administrativ apo mosveprim për nxjerrjen e një akti administrativ nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore 14 Sipas nenit 7 të Ligjit "Për sistemin e taksave vendore", taksapaguesi ka të drejtë të ankimojë kundër:

- a) çdo akti administrativ të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore,
- b) çdo veprimi apo mosveprimi të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore; nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
 - i. që ka të bëjë me taksapaguesin; dhe,
 - ii. ndikon në detyrimin e tij të taksave dhe tarifave vendore.

Akt administrativ konsiderohen të gjitha aktet e nxjerra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore që shkaktojnë efekte financiare dhe/ose ligjore për çdo taksapagues individualisht. Vendimet administrative që mund të ankimohen përfshijnë çdo njoftim vlerësimi apo akt tjetër administrativ që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit, përfshirë llogaritjen e gjobave dhe/ose gabimet në llogaritjen kamatëvonesës.

Ankimi mund të bëhet edhe kundër një mosveprimi, d.m.th. një mosveprimi të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit (p.sh. një akt që nuk është miratuar nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore ose Këshilli Bashkiak brenda periudhës së përcaktuar në ligj, pavarësisht nëse taksapaguesi ka bërë kërkesë në lidhje me të.) Ankimi mund të bëhet nga vetë taksapaguesi apo nga përfaqësuesi i tij dhe mund të përfshijë apelinin e disa vendimeve administrative në të njëjtën procedurë.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankimit, Struktura Vendore e Apelitit, ka të drejtë të grupojë së bashku disa ankime të ngjashme me qëllim të maksimizimit të eficiencës në procedurën e ankimit.

Aktet e Strukturës Vendore të Apelitit të Taksave dhe Tarifave Vendore, që rezultojnë nga procedura e ankimit NUK mund të jenë objekt ankimi administrativ.

Këto vendime MUND të ankimohen vetëm në gjykatë.



2.2.1. Aktet që nuk mund të ankimohen në Strukturën e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore Aktet që nuk mund të ankimohen pranë Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore janë:

- (i) Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administratës tatimore vendore që nuk ndikojnë në detyrimin tatimor vendor të taksapaguesit;
- (ii) Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administratës tatimore vendore që shkelin të drejtat e tatimpaguesve sipas Ligjit "Për procedurat tatimore";
- (iii) Masat administrative të mbledhjes me forcë të detyrimeve.

Në përputhje me parashikimin e nenit 92, kreu XI të Ligjit "Për procedurat tatimore", masat administrative të parashikuara sipas këtij kreu dhe në kapituj të tjerë të këtij ligji, që kanë të bëjnë me masat e mbledhjes me forcë, nuk janë objekt apelimi administrativ pranë Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Megjithatë;

Taksapaguesi ndaj pasurisë së të cilit ka dalë një vendim për vendosjen e masave të sigurisë, në formën e barrës siguroese apo hipotekore, ka të drejtë të paraqesë ankesë tek Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, apo drejtuesi më i lartë i Zyrës së Taksave Vendore sipas organizimit të NJQV, vetëm në ato raste kur zbatimi i masave të sigurisë nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt.

Konsiderohet se ekzekutimi i Vendimit për marrjen e masave të sigurisë nuk është kryer në rregull në rastet e mëposhtme:

- a) kur taksapaguesi nuk ka pasur njoftim me shkrim për sigurimin e detyrimit tatimor, brenda afateve kohore të parashikuara nga Ligji "Për procedurat tatimore";
- b) kur gjatë periudhës së daljes së vendimit dhe ekzekutimit të tij, detyrimi tatimor vendor është paguar; c) nëse pasuria e vendosur si barrë siguroese apo hipotekore, është në grupin e sendeve mbi të cilat nuk mund të shtrihet ekzekutimi sipas nenit 529 të Kodit të Procedurës Civile;
- d) kur akti me anë të të cilit kërkohet të veprohet për ekzekutimin për mbledhjen me forcë të taksave dhe tarifave vendore ka dalë jo në emër të taksapaguesit por kundrejt një personi tjetër. Akti administrativ i konfiskimit i mbajtur sipas nenit 122 pika 4 të ligjit "Për procedurat tatimore", në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative ankimohet administrativisht tek Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, apo drejtuesi më i lartë i Zyrës së Taksave Vendore sipas organizimit të NJQV. Taksapaguesi, në rast se ka konstatuar parregullsi në ekzekutimin e vendimit, e ushtron të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të tyre.

Në çdo rast, në ankesën e tij, taksapaguesi është i detyruar t'i provojë Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore momentin se kur ai ka marrë dijeni për një parregullsi, gjë e cila duhet të provohet me anë të provave shkresore.

Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, apo drejtuesi më i lartë i Zyrës së Taksave Vendore sipas organizimit të NJQV, në përfundim të shqyrtimit, brenda 30 ditëve kalendrike prej marrjes së kërkesës, vendos:

1. Të refuzojë kërkesën nëse nuk është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh nga data e konstatimit të parregullsisë;

2. Të lërë në fuqi vendimin e masës siguroese, barrë siguroese apo barrë hipotekore. Kundër këtij vendimi, taksapaguesi mund të ankimojë tek Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore;



3. Të shfuqizojë plotësisht apo pjesërisht vendimin e masës siguruese, barrë siguruese apo barrë hipotekore.

3. DORËZIMI I ANKIMIT ADMINISTRATIV TATIMOR VENDOR

Kriteret formale të ankimit

(i) Afati i ankimit

Ankimi duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur akti administrativ është marrë ose konsiderohet të jetë marrë. Njoftimi konsiderohet të jetë marrë nga taksapaguesi brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike pas pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Në rastet kur dita e fundit e afatit bie në ditë pushimi apo festë zyrtare, afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

Në qoftë se, në kundërshtim me ligjin, në aktin administrativ mungon njoftimi që informon taksapaguesin për të drejtën e tij për të ankimuar aktin administrativ, përfshirë afatin dhe hallkën e apelimit, taksapaguesi mund të ankimojë brenda 3 (tre) muajve nga data kur akti administrativ është marrë, ose konsiderohet të jetë marrë prej tij. Në rast mosveprimi të administratës tatimore (refuzimi për të nxjerrë një akt), procedura e ankimit fillon tre muaj pas ditës së dorëzimit të kërkesës fillestare për nxjerrjen e aktit administrativ. Në qoftë se ankimi pranë Strukturës Vendore të Apelimit nuk bëhet brenda afatit të caktuar, ai konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

Taksapaguesi mund të kërkojë rivendosjen në afat vetëm nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme respektimi i afatit procedural. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet dorëzuar edhe ankimi pranë Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

(ii) Ankimi bëhet me shkrim

Ankimi duhet të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ankimuesi. Gabime jo materiale, ortografike, apo mungesa që nuk prekin vlefshmërinë apo thelbin, nuk përbëjnë arsye për mos-marrjen në shqyrtim të apelimit. A

(iii) Dokumentacioni shoqërues

Dokumentacioni shoqërues që i bashkëngjitet ankimit duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- a. emrin dhe adresën e taksapaguesit,
- b. numrin identifikues të regjistrimit të taksapaguesit,
- c. aktin administrativ, të lëshuar ose të pa lëshuar nga organi tatimor, që është objekt ankimi duke përfshirë periudhën tatimore përkatëse dhe shumën e detyrimit tatimor,
- d. pagesën ose jo (në përputhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak) të detyrimit tatimor që ankimohet,
- e. arsyet për ankimin e tij,
- f. informacion në mbështetje të ankimit (Aktin e kontrollit, proces-verbalet, etj.)
- g. çdo dokument tjetër që ankimuesi e gjykon të rëndësishëm,
- h. nënshkrimin e tij.



(iv) Pagesa e detyrimit të ankimuar

Në përputhje me Nenin 5, pika ç,v), te Ligjit 9632 " Për Sistemin e Taksave Vendore", Këshilli Bashkiak përcakton kriteret dhe procedurat e marrëdhënieve me taksapaguesit, përfshirë të drejtën e tyre të ankimit.

Është e drejta e Këshillit Bashkiak për të vendosur nëse taksapaguesi duhet të parapaguajë ose jo detyrimin tatimor për të cilin ankohet, ose ta parapaguajë pjesërisht atë.

Në rastin kur Këshilli Bashkiak, ka vendosur në favor të parapagimit, ankimi pranohet në qoftë se ankimuesi:

a. parapaguan shumën e plotë/pjesëshëm të detyrimit tatimor, objekt ankimi të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet, përfshirë ose jo kamatëvonesat/gjobat përkatëse, ose vendos garanci bankare për këtë shumë me afat minimalisht 6 muaj, por jo më pak se afati sipas të cilit vendimi merr formë të prerë;

b. vërteton pagesën ose garancinë, duke paraqitur një kopje të dokumentit të pagesës së detyrimit tatimor objekt ankimi ose të garancisë bankare.

Taksapaguesi pajiset nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me një dokument urdhër pagesë ku pasqyrohet saktësisht detyrimi tatimor për t'u paguar.

Në qoftë se taksapaguesi nuk paguan shumën e caktuar para skadimit të afatit të ankimit, ose nuk vendos garancinë bankare, ankimi konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

Në qoftë se nuk plotësohet ndonjë prej kërkesave të përmendura në paragrafët (i) deri në (iv) më lart, Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore i kërkon taksapaguesit ta ridërgojë ankimin e tij të plotësuar si duhet me informacionin e kërkuar brenda 15 ditëve kalendarike.

Taksapaguesi nuk mund të apelojë në gjykatë një akt administrativ që është objekt ankimi në Strukturën Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, pa patur një Vendim të kësaj Strukturi lidhur me këtë akt administrativ. Në rastet kur Struktura Vendore e Apelimit nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, taksapaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë.

4. VEPRIMET E NDËRMARRA NGA STRUKTURAVENDORE E APELIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

4.1. Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore shqyrton dhe merr vendime të pavarura për ankimet e paraqitura nga taksapaguesit. Ajo i bazon vendimet e saj në provat dhe argumentet e paraqitura nga taksapaguesi dhe administrata tatimore vendore. Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore mund të kërkojë informacion shtesë, p.sh. dokumente të tjera nga taksapaguesi, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga palë të treta, si dhe mund të bëjë verifikime që ndihmojnë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes.

4.2. Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore e kufizon shqyrtimin e ankimit vetëm në çështjet e ngritura nga taksapaguesi në ankim. Në qoftë se gjatë procedurës zbulohen fakte të reja që provojnë se detyrimi tatimor i përcaktuar nuk është i mjaftueshëm, Struktura e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk mund ta rrisë vetë detyrimin tatimor.

